



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TEPELENË
KËSHILLI BASHKIAK TEPELENË

Nr. 255/4 prot.

Tepelenë, më 02.02.2026

V E N D I M

Nr. 5, datë 29. 01. 2026

PËR ZHVILLIMIN E PRONËS NË FSHATRAT SALARI, ME NUMËR PASURIE 1094/4, 1094/5; ZONA KADASTRALE NR. 3252, GUSMAR ME NUMËR PASURIE 764, 134, 131,182, 132, ZONA KADASTRALE NR. 1913, PROGONAT ME NUMËR PASURIE 735, 752, 717, 721, 722, 729, 728, 702, 700, 625, 630, 636, 399, 649, 659, 682, 686, ZONA KADASTRALE NR. 3057, ME ZHVILLUES FONDIN SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT SI DHE AUTORIZIMIN E ZHVILLUESIT APO PËRFAQËSUESIT, TË APLIKOJË PËR PAJISJEN E OBJEKTIT/INVESTIMIT ME LEJET PËRKATËSE, NË PORTALIN “E-ALBANIA”

Bazuar në: Nenin 8, pika 2, nenin 9, pika 1/1.1, shkronja “b” dhe pika 1/1.2, nenin 27, pika 5, nenin 36, nenit 54, shkronja “e”, nenit 55, pikat 4 dhe 6 të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, e ndryshuar; Ligjin nr. 115/2014, datë 31.07.2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njërive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, e ndryshuar; Ligjin nr. 8743, datë 22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, e ndryshuar; Ligjin nr. 8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, e ndryshuar; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 6, datë 06.01.2011 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Tepelenë të Qarkut të Gjirokastrës”; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 430, datë 11.07.2018 “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore për sistemin elektronik të lejeve (e-Leje)”; Ligjin nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” të ndryshuar; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, të ndryshuar; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 686, datë 22.11.2017 “Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit”, të ndryshuar; Relacionit nr. 172 prot, datë 23.01.2026 të Grupit të punës pranë Bashkisë Tepelenë, Këshilli Bashkiak Tepelenë,

V E N D O S I:

1. Zhvillimin e pronës në fshatrat Salari me numër pasurie 194/4, 194/5, Zona Kadastrale nr. 3252, Gusmar me numër pasurie 764, 134, 133, 132, Zona Kadastrale nr.1913, Progonat me numër pasurie 735, 752, 717, 721, 722, 729, 728, 702, 700, 625, 630, 636, 399, 649, 659, 682, 686, Zona Kadastrale nr.3057, me zhvillues Fondin Shqiptar të Zhvillimit si dhe autorizimin e zhvilluesit apo përfaqësuesit, të aplikojë për pajisjen e objektit/investimit me lejet përkatëse, në portalin “e-albania.

2. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar si dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Gjirokastrë.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Valbona ÇELA



Miratuar me:	12 (dymbëdhjetë) vota
Vota Pro	12 (dymbëdhjetë) vota
Vota Kundër	0
Vota Abstenim	0

Zbardhur më datë 02.02.2026

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

